

# Formula e dritës në një vëllim poetik

Nga Anton Çefa

(VIJON NGA NUMRI I KALUAR)

Në këtë sintagmë ligjërimi, zakonisht, peshën më të rëndë kuptimore e bart fjala e fundit, por gjithësesi e plotësuar, e cilësuar prej gjymtyrëve tjera përcaktuese.

Po e sqaroj me shembuj:

Fjala ëndërr, në përshtatje me motivin që trajtohet dhe në shërbim të ngarkesës emocionale që bart; është dhënë në sintagma të tilla: "çarçafët e bardhë të ëndrrave", "tunelet e urithëta të ëndrrave", "me maskën e ëmbël të një ëndrre në fytyrë", "fllad i paprekshëm ëndrre", "gjeografisë së ëndrrave", "furgëza prej ëndrre"...Të gjitha këto ndërtime sintagmatike synojnë në realizimin e një përfytyrimi sa më të plotë të këtij nocioni, me ngarkesë emocionale pozitive a negative, simbas rastit.

Për një shpresë tepër të zbehtë thuhet "dritarja kanatëkalbur e shpresës", ku sintagma trigjymtyrëshë ka, në kuptimin figurativ, vlerën e një njësie ligjërimore me një forcë të jashtëzakonshme përfytyrimi. Kështu me gjymtyrë treshe, por me vlerën e një njësie ligjërimore, janë ndërtuar figurat: "globit qelqor të dashurisë", "trazirat e errëta të qiellit", "java e fundit e tokës", "mureve ajrore të kujtesës", "tunnelin e vranët të gushtit", "ngjyrat e erës së durimit", "gishtërinj të ashpër urtësisë", "jargët e ditëve të liga", "çarçafët e bardhë të ëndrrave", "dritarja e rrëzimit të kambanave", "anije pirate të vështrimit". Dhe, më përtej, me katër gjymtyrë: "dekoret e qafës së hollë të një shprese", "shatërvanë të paprekshëm sedre kombëtare", me një ngarkesë ideoemocionale të pasur dhe befasuese.

Një dukuri e tillë ka nxjerrë kokën në poezinë franceze të gjysmës së dytë të shekullit të kaluar, me Artur Rembonë dhe poetë të tjerë të brezit të tij. Në poezinë tonë të sotme, metafora e shprehur në një sintagmë dygjymtyrëshe me vlerën e një njësie ligjërimore është bërë pothuajse e zakonshme, ndërsa të ndërtuarit e saj me sintagmë tre e katërgjymtyrëshe është fare i rrallë. Në vëllimin poetik "Na ish një tors dashurie" të poetit të ri Gazmend Krasniqi, siç e ka vërejtur kritiku i talentuar Adrian Marashi

(Shih "Shkodër-Stinë e re botimesh", "Hylli i Dritës", 1994, nr. 5-6), një ndërtim i tillë është absolutizuar duke i dhënë vëllimit "një uniformitet të pashmangshëm në planin figurativ".

Dalloja e dytë e veçantisë së ndërtimit figurativ sendërtohet me një realizim tërësor metaforik, me veshjen e poezisë a të një pjese të saj, zakonisht të një strofe, me një mantel metaforik. Thënë ndryshe, me krijimin e një tabloje metaforike.

Në një poezi, ndjenja e mungesës së vazhës së dashuruar është dhënë me sintagmën dyshe "detit të mungesës", në kuptimin e një mungese të thellë, të gjerë e të trazuar si deti. Po kjo gjendje emocionale në poezinë "Për ty" (f. 36) është dhënë me një ndërtim tërësor metaforik kështu:

"Mungesa kasollën e saj prej prushi ka ngritur në lëkurën time,  
e cila djersin shkujdesur imazhin tënd"  
Po e sqarojmë më tej këtë çestije:

Në poezinë "Minutat pjellin ditëplakje" (f. 87), me motiv Kosovën, njëmendësohet ideja se është bërë e padurueshme, anakronike, robëria e saj, koha e kësaj robërie ka tejkaluar çdo cak dhe se asaj duhet t'i jepet liria:

"Muzgu ligështar -  
një gotë e holluar errësire,  
zbret shkallët e flamta  
të pritjes së grisur"

Kosova përjeton muzgun e robërisë. E tëra kjo strofë përbën një tablo figurative të mbështetur në një metaforë të vetme me detaje figurash elegante, që spikasin në poezi me ngjyrat e tyre lirike. Muzgu, nga ana e tij, është ligështar - një epitet i papritur me një ngarkesë të madhe figurative e emocionale. Ky lloj muzgu, i dhënë me një metaforë brenda metaforës së gjithë strofës është "një gotë e holluar errësire"; pra një muzg që nënkupton më shumë dritë se errësirë, duke dhënë kështu idenë e vigjiljes së lirisë- gjë që e pasqyron në mënyrë të jashtëzakonshme idenë që muzgu "zbret shkallët e flamta të pritjes së grisur". Pritja e ditës së fundit të robërisë, e ardhjes së lirisë, po jeton muzgun e saj dhe vetë muzgut i



Ballina e librit "Infini"

ka ardhur fundi. Gota e errësirës-vetë errësira-me të cilën metaforizohet ai, është e holluar dhe shkallët e pritjes "ku zbret" janë "të flamta", pra të sëmura dhe vetë kjo pritje është si një robë e grisur.

Vargu i shkëputur: "Minutat pjellin ditëplakje" i vë cakun më të skajshëm idesë dhe figurës së strofës së parë: çdo minut që kalon "e plakë" ditën e pritjes.

Në strofën e fundit-një ndërtim tjetër tërësor figurativ-kalohet nga Kosova tek diplomacia botërore që e mban atë me shpresa, nëpërmjet stërholimeve diplomatike.

Në strofën e fundit, me dy vargje, jepet fundi i robërisë së Kosovës, jo si një kërkesë nga bashkësia ndërkombëtare, por si një urdher i drejtësisë historike e humane dhe si mesazh i poetit:

"Kosova nuk do të mbetet kështu  
si një ombrellë e mbyllur sentimentit."

Kështu, Kosova nuk duhet të jetë për botën thjeshtë një objekt dhimbjeje. Në një rrafsh më të përtejme të komentit: ajo duhet të jetë një ombrellë e hapur e drejtësisë historike.

Ndërtimi i ndërlikuar figurativ ka vetëdijësuar poetin në drejtim të zgjedhjes me një shije të veçantë lirike të fjalorit poetik për të përcjellë tek lexuesi përvojën e tij. Dhe këtu- pa ia falur përdorimin e fjalëve të huaja të panevojshme- ai është treguar mjeshtër, jo vetëm në zgjedhjen e fjalës, në përdorimin e saj shpesh në një formë të re, por edhe në krijimin e kompozitave në shërbim të sendërtimit të figurës, sidomos epitetit dhe krahasimit. Nuk njoh në poezinë tonë të sotme një rast tjetër të tillë. Në poezinë e traditës janë shquar në këtë drejtim Poradeci, Noli dhe Koliqi.

Fjala në poezinë e Marinajt është ngjyrë, tingull, ide; ajo ka ngjyrë të theksuar ndjenjeje, tingull të veçantë, të harmonishëm e melodioz, që i japin asaj një ngarkesë të fuqishme ideore e emocionale, shpesh befasuese.

Ja disa fjalë të përdorura në mënyrë origjinale: (vise) të përdiellta, (koha) e fëmijësuar, (gjuhë) tamlorë, (dashuri) e pjergulluar, (e sotmja) e përfjalëshme, (ti largoheshe) në blutësinë e (gjoksit të detit), (gjuhë) detishte, (në këtë) tmerrishtë.

I pashëmbullt është përdorimi i kompozitave, ne pjesën më të madhe të krijuara prej tij, sipas natyrës së gjuhës sonë: jetësosje, luleëndërr, hapjembyllje (e qepallave), ndjenjësvarje, ëmbëlzërat, i vetëdënuar, gjysmëdhës, kanatëkalbur, plagëmbyllës, parmaktrishtë, ndjenjëfjetur, fjalësheshtur, zhurmëzhuritur, botëfalitur, keqparë, keqhekur, dikuhumbur, rërëprushë, shkrunbfikur, lëkurëlëmuar, rreze-fyer, etj.

Kështu, Marinaj, me këtë përmbledhje të re poetike, duke treguar një përkujdesje të përkushtuar për fjalën shqipe, një vlerësim të lartë për ndërtimin figurativ dhe duke dëshmuar një nderim të veçantë deri në adhurim për poezinë, përbën një derdhje të re poetike të shumëvlershme në lumin e poezisë sonë të sotme. Poezia e Marinajt është një poezi "e lindur në mundime prej guri", do të thoja duke huazuar një varg të Camajit.

**International Driver's License**  
Translated from your original driver's license by IADC International Driver's License is issued according to Geneva Convention on Road Traffic

**ONLY ORIGINAL DRIVER'S LICENSE NEEDED FROM ANY COUNTRY**

IF YOU WANT TO RECEIVE YOUR CARD BY MAIL, YOU SHOULD PROVIDE THE FOLLOWING INFORMATION:

- 1) FIRST NAME, LAST NAME
- 2) FULL ADDRESS AND TEL #
- 3) DATE OF BIRTH
- 4) COUNTRY OF BIRTH
- 5) SEX (M) (F)
- 6) COLOR OF EYES
- 7) HEIGHT IN FEET AND INCHES
- 8) SIGNATURE
- 9) COPY OF DRIVER'S LICENSE FROM ANY COUNTRY (FOR DL)
- 10) 1 PHOTO (PASSPORT SIZE)
- 11) MONEY ORDER PAYABLE TO IADC CO FOR \$49.00 (DL) OR \$29.00 (ID) (\$4.00 - SHIPPING AND HANDLING)

<http://www.iadc-world.com>

IF YOU'D LIKE TO GET SOCIAL SECURITY SUBSTITUTION, I.E. TAXPAYER IDENTIFICATION NUMBER, YOU HAVE TO ADD THE FOLLOWING:

**MONEY ORDER FOR \$70.00 and:**

- 1) NOTARY CERTIFIED PHOTOCOPY OF YOUR PASSPORT (OR DL, OR BIRTH CERTIFICATE, OR MILITARY ID, OR INS DOCUMENTATION, ETC.)
- 2) ADDRESS IN YOUR NATIVE COUNTRY
- 3) FATHER'S LAST AND FIRST NAMES
- 4) MOTHER'S LAST AND FIRST NAMES
- 5) COUNTRY OF CITIZENSHIP
- 6) TYPE OF VISA (IF ANY) AND EXPIRATION DATE (OPTIONAL)

1739 SHEEPSHEADBAY RD, BROOKLYN, NY 11235  
tel (718) 891-8159, 891-8169, tel/fax (718) 891-8149  
Subway trains D&Q to SHEEPSHEADBAY Office Hours: M-F 10-7:30 S-S 10-3

**SPECIAL PRICE FOR AGENTS**

**AZIL**

**Ish prokuror shteti**  
**Andrew P. Johnson**  
**Hilmi Shehu**

**Siguron mbrojtje ligjore ndaj ndallimeve prej INS.**  
**Përfaqësime në raste apollmi dhe bashkime familjare**

[www.greencard-visa.com](http://www.greencard-visa.com)

**NE SHQIP KONTAKTONI NE TELEFONIN:**  
**718-645-2853**

**TELEPHONE IN ENGLISH: 212-693-3355**

**Law Offices of Andrew P. Johnson**  
305 Broadway, 11th Floor, Suite 1100  
New York, NY 10007

**FIORINO RISTORANTE**

38 Maple Street, Summit, NJ 07901  
Tel. (908) 277 - 1900 • Fax: (908) 277 - 1901  
[www.fiorinoristorante.com](http://www.fiorinoristorante.com)